



Raporti

Studim Projektim i rruges Kardhiq Delvine.

Tirane Korrik 2021



Rr. Tish Daija; Pall. 7; Ap 28

Kompleksi "KIKA I RI"

Phone 00355 66 40 55 663

E-mail : ave_consulting@yahoo.com

Studim Projektim i rruges Kardhiq –Delvine .

Nenprojekti

Mbrojtja dhe Rivitalizimi I skarpatave.

Raporti i Projektit

Version	Data	Autoret	Aprovimi	Komente
PZ v.00	Korrik 2021	Ervin Paçi		



Përmbajtja e raportit

1. TE PËRGJITHSHME.....	8
1.1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT DHE POZICIONI GJEOGRAFIK.....	8
2. QËLLIMI I PROJEKTIT	10
3. PROJEKTI I ZBATIMIT	11
3.1 PROÇESET FIZIKO - GJEOLGJIKE DHE GJEODINAMIKE	11
3.2 GJENDJA AKTUALE E SKARPATAVE DHE SHKAQET E NDODHJES SE PROCESVE FIZIKO –GJEOLGJIKE DHE GJEODINAMIKE.	11
A. LOTI 1 –ZONA 1 E MBROJTJES, SEGMENTI 1+669.89÷1+980.97	12
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	13
A. LOTI 1 –ZONA 2 E MBROJTJES, SEGMENTI 3+395.34÷3+843.58	15
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	16
A. LOTI 1 –ZONA 2A E MBROJTJES, SEGMENTI 4+394.95÷4+500	18
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	19
A. LOTI 4 –ZONA 2B E MBROJTJES, SEGMENTI 7+198.08÷7+250+15	21
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	22
A. LOTI 4 –ZONA 2A E MBROJTJES, SEGMENTI 8+150÷8+225	24
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	25
A. LOTI 4 –ZONA 2 E MBROJTJES, SEGMENTI 8+565÷9+425	26
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	28
A. LOTI 4 –ZONA 1 E MBROJTJES, SEGMENTI 9+875÷12+800 DHE 12+925÷13+275	30
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	32
A. LOTI 6 –ZONA 3 E MBROJTJES, SEGMENTI 16+675÷18+125	35
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	36
A. LOTI 6 –ZONA 2 E MBROJTJES, SEGMENTI 18+500÷19+225	39
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	40
A. LOTI 6 –ZONA 1 E MBROJTJES, SEGMENTI 19+650÷20+275	41
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	42
A. LOTI 5 –ZONA 7 E MBROJTJES, SEGMENTI 20+350÷20+425	44
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	45
A. LOTI 5 –ZONA 6B E MBROJTJES, SEGMENTI 20+660÷20+800	46
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	47
A. LOTI 5 –ZONA 6A E MBROJTJES, SEGMENTI 20+894÷21+295	49
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	50
A. LOTI 5 –ZONA 6 E MBROJTJES, SEGMENTI 21+260÷21+390	52
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	53
A. LOTI 5 –ZONA 5 E MBROJTJES, SEGMENTI 21+430÷21+575	55
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	56
A. LOTI 5 –ZONA 4 E MBROJTJES, SEGMENTI 21+650÷22+100	57
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	58
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
A. LOTI 5 –ZONA 2 E MBROJTJES, SEGMENTI 22+323.63÷22+450	60
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	61



Rr. Tish Daija; Pall. 7; Ap 28

Kompleksi "KIKAI RI"

Phone 00355 66 40 55 663

E-mail : ave_consulting@yahoo.com

A. LOTI 5 –ZONA 1 E MBROJTJES, SEGMENTI 22+875÷23+032.66	62
B. ZGJIDHJA SIPAS FORMACIONIT GJEOLGJIK TE KËTIJ SEGMENTI.	63
<u>4. METODOLOGJIA E PUNIMEVE DHE SPECIFIKIME PËR MATERIALET</u>	68
4.1 METODOLOGJIA E PUNIMEVE.....	68
4.2 SPECIFIKIME TEKNIKE PËR MATERIALET	71
<u>5. ANALIZA GJEOTEKNIKE E SHPATIT NATYRAL</u>	79
5.1 MODELET LLOGARITESH.....	79



Lista e figurave

Figure 1 Pozicioni gjeografik i zones.....	8
Figure 2 Foto: km 1+900.....	12
Figure 3 Seksion tip/ prerje terthore Zona 1-Lot1 km 1+980.97	13
Figure 4 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 1-Lot 1 nga km 1+669.89÷1+980.97	14
Figure 5 Foto: km 3+800.....	15
Figure 6 Seksion tip/ prerje terthore Zona 2-Lot1 km 3+519.79	16
Figure 7 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 2 – Lot 1 nga km 3+395.34÷3+843.58.....	17
Figure 8 Foto: km 4+395 deri ne km 4+500.	18
Figure 9 Seksion tip/ prerje terthore Zona 2 a-Lot1 km 4+454.32.....	19
Figure 10 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 2 a – Lot 1 nga km 4+394.95÷4+500	20
Figure 11 Foto nga Km 7+198.08 ÷ 7+250 + 15m rakordim.....	21
Figure 12 Seksion tip/ prerje terthore Zona 2 b-Lot 4 km 7+200.....	22
Figure 13 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 2 b – Lot 4 nga km 7+198.08 ÷ 7+250+15m rakordim .	23
Figure 14 Foto ne terren nga Km 8+150-8+225	24
Figure 15 Seksion tip/ prerje terthore Zona 2 a-Lot 4 km 8+200.....	25
Figure 16 Seksion tip/ (ne zona shume te dobeta me dhera) prerje terthore Zona 2 a-Lot 4 km 8+200..	26
Figure 17 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 2 b – Lot 4 nga km 8+150÷8+225.....	26
Figure 17 Foto: km 8+565 deri ne km 9+425 me shkembinjte gelqerore strallore dhe me çarje.	27
Figure 18 Seksion tip/ prerje terthore Zona 2 -Lot 4 km 9+225.....	28
Figure 19 Seksion tip (ne zona te dobeta me dhera)/ prerje terthore Zona 2 -Lot 4 km 9+225.....	Error!
Bookmark not defined.	
Figure 19 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 2 – Lot 4 nga km 8+565÷9+425	29
Figure 20Foto: km 9+875 deri ne km 12+800 me shkembinjte gelqerore.....	30
Figure 21 Foto: km 11+375 deri ne km 12+150 me shkembinjte gelqerore me çarje, shkarje dhe zgavrakarstike.....	30
Figure 22 Foto: km 12+925 deri ne km 13+275 me shkembinjte gelqerore shume te copetuar.	31
Figure 23 Seksion tip/ prerje terthore Zona 1 -Lot 4 km 9+925.....	32
Figure 24 Seksion tip zona te dobeta me dhera/ prerje terthore Zona 1 -Lot 4 km 9+925	33
Figure 25 Seksion tip/ prerje terthore Zona 1 -Lot 4 km 11+125.....	33
Figure 26 Seksion tip ne zona te dobeta me dhera / prerje terthore Zona 1 -Lot 4 km 11+125	33
Figure 27 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 1 – Lot 4 nga km 9+875÷12+800.....	34
Figure 28 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 1 – Lot 4 nga km 12+925÷13+275.....	34
Figure 29 Foto nga 16+675 dhe 18+125me shkembinjte gelqerore mergelore, alevrolite, dhe mergele me çarje dhe zgavra karstike.....	35
Figure 31 Seksion tip/ prerje terthore Zona 3 -Lot 6 km 17+000.....	37
Figure 32 Seksion tip/ prerje terthore Zona 3 -Lot 6 km 17+400.....	37
Figure 33 Seksion tip/ prerje terthore Zona 3 -Lot 6 km 17+600.....	37
Figure 34 Seksion tip/ prerje terthore Zona 3 -Lot 6 km 17+750.....	38
Figure 35 Seksion tip/ prerje terthore Zona 3 -Lot 6 km 17+975.....	38
Figure 36 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 3 – Lot 6 nga km 16+675÷18+125.....	38
Figure 37 Foto nga km 18+500 deri ne km 19+225.....	39
Figure 38 Seksion tip/ prerje terthore Zona 2 -Lot 6 km 19+150.....	40



Figure 39 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 2 – Lot 6 nga km 18+500÷19+225.....	40
Figure 41 Seksion tip/ prerje terthore Zona 1 -Lot 6 km 19+875.....	42
Figure 42 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 1 – Lot 6 nga km 19+650÷20+275.....	43
Figure 43 Foto: km 20+350 deri ne km 20+425 me shkëmbinjte gelqerore me shume çarje.....	44
Figure 44 Seksion tip/ prerje terthore Zona 7 -Lot 5 km 20+375.....	45
Figure 45 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 7 – Lot 5 nga km 20+350÷20+425.....	45
Figure 46 Foto: km 20+660 deri ne km 20+800 me shkëmbinjte gelqerore pllakore dhe shume te çare.	46
Figure 47 Seksion tip/ prerje terthore Zona 6 b -Lot 5 km 20+725.....	47
Figure 48 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 6 b – Lot 5 nga km 20+660÷20+800.....	48
Figure 49 Foto: km 20+894 deri ne km 21+245 me shkëmbinjte gelqerore pllakore dhe me blloqe te rrezuar.	49
Figure 50 Seksion tip/ prerje terthore Zona 6 a -Lot 5 km 21+025.....	50
Figure 51 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 6 a – Lot 5 nga km 20+894÷21+245.....	51
Figure 52 Foto: km 21+260 deri ne km 21+390 me shkëmbinjte gelqerore shtresore, te rudhosur dhe me shume çarje.	52
Figure 54 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 6 – Lot 5 nga km 21+260÷21+390.....	54
Figure 55 Foto: km 21+430 deri ne km 21+575 me shkëmbinjte Flishore (Argjilite, Alevrolite, Ranore).	55
Figure 56 Seksion tip/ prerje terthore Zona 5 -Lot 5 km 21+490.31.....	56
Figure 57 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 5 – Lot 5 nga km 21+430÷21+575.....	56
Figure 58 Foto: km 21+650 deri ne km 22+100 me shkëmbinjte Flishore (Argjilite, Alevrolite, Ranore) dhe filtrimet e ujit.....	57
Figure 59 Seksion tip/ prerje terthore Zona 4 -Lot 5 km 22+035.81.....	58
Figure 60 Seksion tip/ prerje terthore Zona 4 -Lot 5 km 21+750.....	59
Figure 61 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 4 – Lot 5 nga km 21+650÷22+100.....	59
Figure 62 Foto nga km 22+125 deri ne 22+175.....	59
Figure 63 Seksion tip/ prerje terthore Zona 3 -Lot 5 km 22+150.00.....	59
Figure 64 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 3 – Lot 5 nga km 22+125÷22+175.....	59
Figure 65 Foto: km 22+323.63 deri ne km 22+450 me shkëmbinjte Flishore (Argjilite, Alevrolite, Ranore).	60
Figure 68 Foto: km 22+865 deri ne km 23+032.66 Depozitimet zhavorrore mbi ato Flishore.....	62
Figure 69 Seksion tip/ prerje terthore Zona 1 -Lot 5 km 22+900.00.....	63
Figure 70 Seksion tip/ prerje terthore Zona 1 -Lot 5 km 23+025.....	64
Figure 70 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 2 – Lot 5 nga km 22+865÷23+032.66.....	64
Figure 71 Vendosja e paneleve te rrjetes ne skarpate.....	68
Figure 72 Përshkrimi i rrjetes.....	70
Figure 73 Menyra e lidhjes se paneleve te rrjetes ndermjet tyre.....	71
Figure 74 Specifikimet teknike për rrjeten.....	71
Figure 75 Metoda e anorimit.....	72
Figure 76 Fiksimi I rrjetes me ankora dhe pllaken e ankorit.....	73
Figure 77 Pamje ballore e rrjetes dhe ankorimit te përfunduar.....	73
Figure 78 Pamja e vendosjes ne plan e barriers mbrojtese.....	76
Figure 79 Pamje nga testi dinamik I goditejs ne nje moster te barrieres mbrojtese.....	77
Figure 80 Skema e pamjes përballë te barrieres mbrojtese.....	78
Figure 81 Harta e rrezikut sizmik për Shqipërine.....	87



Rr. Tish Daija; Pall. 7; Ap 28

Kompleksi "KIKAI RI"

Phone 00355 66 40 55 663

E-mail : ave_consulting@yahoo.com

Lista e Tabelave

Table 1. Tabela përmbledhese. Problematikat e shpateve. Rruga Kardhiq Delvine	65
Table 2. Klasifikimi I ndikimit te problematikes	67
Table 3. Klasifikimi I origjines se problematikes	67
Table 4. Numri i testeve te kerkuara për ankorat	74
Table 5. Parametrat fizike te lendes se pare për tubat e drenazhimit: HDPE 100.....	75

T

1. Te përgjithshme

Bazuar ne projektin për mbrojtjen e skarpatave lidhur me rrugën “Kardhiq-Delvine” me poshtë vijon raporti teknik për zbatimin e projektit sipas te gjitha specifikimeve te përcaktuara nga projektuesi dhe raporti gjeologjik.

1.1 Përshkrimi i projektit dhe pozicioni gjeografik

Rruga Kardhiq –Delvine ka nje gjatesi 33 km dhe shtrihet ne jug te Shqipërise dhe përshkon rrethin e Gjirokastrës, Delvines dhe Sarandes. Aksi fillon ne Urën e Kardhiqit dhe mbaron ne hyrje te qytetit te Delvines. Zona eshte me relief kodrinor dhe malor. Rruga nderpritet nga disa përrenj te vegjël dhe ndjek luginen e lumit te Fushe-Bardhes.




Figure 1 Pozicioni gjeografik i zones



Rr. Tish Daija; Pall. 7; Ap 28

Kompleksi "KIKAI RI"

Phone 00355 66 40 55 663

E-mail : ave_consulting@yahoo.com

Ne zonën ku kalon ky segment rrugor kemi dy njësi gjeomorfologjike të mëdha; Njësia e parë është fusha e Ures së Kardhiqit dhe fusha ku është ndërtuar qyteti i Delvines dhe kodrat e Lugines nga Fushe-Bardha deri në Delvine.

-Fusha e Kardhiqit dhe Delvines; Përfaqëson një gropë të madhe e cila është krijuar nga aktiviteti tektonik në periudhë të Neogjen-Kuaternarit. Gropa e krijuar nga levizjet tektonike të asaj periudhe është mbushur me depozitimet aluviale të përrejtë dhe të lumëve të pellgut të Kardhiqit dhe të Delvines.

Kjo fushë rrethohet nga malet e Fushe-Bardhes dhe kodrat e Delvines qëndrohen nga shkëmbinj sedimentarë, flishe dhe shkëmbinj karbonatike. Ato kanë shpatë pothuajse të zhveshura nga bimesia.

Nga vërtetimet në terren mbas ndërhyrjes për ndërtimin e rruges së re, janë takuar fenomene negative fiziko-gjeologjike të cilat kërcenojnë qëndrueshmërinë e trupit të rruges së re. Rruga kalon pothuajse në mesin dhe në fundin e kësaj lugine.



Rr. Tish Daija; Pall. 7; Ap 28

Kompleksi "KIKAI RI"

Phone 00355 66 40 55 663

E-mail : ave_consulting@yahoo.com

2. Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit është mbrojtja, rivitalizimi dhe stabilizimi i skarpateve në germime dhe në mbushje për rrugën e re nga Ura e Kardhiqit deri në Delvine.

Për realizimin e këtij qëllimi synohet një zgjidhje afatgjate që të sigurojë stabilitetin, qëndrueshmërinë dhe pejsazhin e gjithë shpateve të ndikuar nga hapja e rruges.

Zgjidhjet e propozuara nga projektuesi është bërë bazuar mbi parametrat gjeoteknike të raportit gjeologjik.

Keto zgjidhje konsistojnë në qepjen e shpateve/skarpave. Për keto ndërhyrje përpara zbatimit duhet të zbatohen të gjitha përshkrimet dhe kërkesat e paraqitura sipas projektit.

Ky raport detajon dhe shpjegon modelin e zgjedhur për secilën zonë. Për më tepër, do të përshkruhen të gjitha punët e kerkuara dhe aktivitetet përkatëse që do të kryhen sipas vizatimeve dhe specifikimeve teknike për secilën zonë.

Gjate ekzekutimit të punimeve, secili prej inxhinierëve përgjegjës do të mbështetet në këtë dokument për të planifikuar dhe organizuar punimet bazuar në të.

Mbrojtja e shpatit do të kryhet në zonat e raportuara sipas secilit seksion tip.

Si funksionojnë keto lloj propozimesh/zgjidhjesh? Veshja mbulon faqen e ekspozuar të skarpates dhe mund të sigurojë një funksion stabilizues për të siguruar mbrojtje nga erozioni dhe për të nxitur rivegjetimin e shpatit.



3. Projekti i zbatimit

3.1 Proçeset Fiziko - Gjeologjike dhe Gjeodinamike

Ne studimin e fenomeneve gjeologjike te kesaj zone raporti gjeologjik i realizuar nga "Altea&GeoStudio2000" dhe eshte dhene si raport me vete jep informacion qe eshte bazuar ne studimet ekzistuese dhe studimet aktuale.

Bazuar ne keto te dhena po bejmepërshkrimin e fenomeneve gjeologjike qe jane prezente ne formacionet gjeologjike qetakohen ne kete zone.

Fenomenet me te dukshme gjeologjike dhe gjeodinamike qe verehen ne kete zone jane:

1. Erozioni

2. Fenomeni i përjimit

3. Shembejet dhe rreshqitjet e formacioneve mbulesore dhe rrenjesore

3.2 Gjendja aktuale e skarpatave dhe shkaqet e ndodhjes se proceseve fiziko – gjeologjike dhe gjeodinamike.

Qendrueshmeria e Skarpatave ne zonat me germime dhe mbushje; Ne zonën ku kalon rruga e re nga Ura e Kardhiqit deri ne Delvine, mbas gemimeve dhe mbushjeve qe jane kryer gjate ndërtimit te rruges se re ka disa zona me qendrueshmeri te dobet ku jane verejtur rreshqitje te skarpatave, rrezime te materileve ne rrugën e re.

Keto jane zona te vogla te cilat jane te predispozuara për te rreshqitur mbas ndërhyrjes për ndërtimin e rruges se re.

Keto zona takohen ne zonën ku rruga ere kalon ne zonën shpatore qe ndertohen nga shkembinj Flishore dhe Rreshpore.

Zonat ku jane prezente shkembinjte gelqerore jane te qendrueshme.

Zona malore ku kalon rruga e re ne nje periudhe te gjate te vitit eshte e mbuluar me debore dhe eshte ne kushte te lageshtires, ne kete situatë masat dherore jane te ngopura me uje dhe për forcen e renies se lire levizin ne drejtim te renies se relievit. Ato levizin dhe brenda shtresave argjilore dhe ne kontaktet me pjesen e përjruar te fromacionit rrenjesor. Nga shpimet dhe nga gropat qe jane kryer ne fazen e projektit nuk jane takuar rrafshe rreshqitje ne masen e dherave dhe ne kontaktin me formacionet rrenjesore qe përbehen nga shkembinj flishore. Por pas ndërtimit te rruges se re ne rastin e germimeve ose mbushjeve jane krijuar ne zonën ku eshte prishur ekuilibri i qendrueshmerise se shpatit.

*** Rruga Kardhiq –Delvine ka nje gjatesi 33 km, projekti I mbrojtjes do jete vetem nga kilometri 0 deri ne kilometrin 23, pasi vetem kjo pjese ka skarpata te larta dhe me rrezik nga renia e materialit ne trupin e rruges, ndersa pjesa tjeter nga kilometri 23-33, eshte zone fushore dhe si rrjedhoje nuk kemi skarpata ne germim.**

a. Loti 1 –Zona 1 e mbrojtjes, segmenti 1+669.89÷1+980.97

Ne kete segment takohen shkembinjte FLISHORE te përfaqesuar prej kombinimit te shkembinjeve Argjilite, Alevrolite dhe Ranor, shtrese holle, mesatarisht te dobet, te përjruar ne sipërfaqe, me ngjyre gri. Trashesia e ranoreve kokrrize-imet varion nga 2cm deri ne 20cm dhe e argjiliteve 2-7cm.

Gjithashtu nga vrojtimet ne terren verifikohen rrjedhje sipërfaqesore si shkak i ndikimit klimaterik (shirat, niveli i ujerave nentokesore). Rrjedhjet jane te shpeshta dhe kane mbushur jo vetem pjeset e poshtme te skarpatave por kalojne edhe ne rruge. Ne faqen e skarpates, ne disa vende te saj, vihen re njolla te lageshtise prej filtrimeve te ujerave nentokesore. Keto ujera jane edhe nje faktor tjetër me shume qendikojne ne shkarje e ketyre depozitimeve ne drejtim te trupit te rruges.



Figure 2 Foto: km 1+900

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Ndërhyrja e parashikuar për mbrojtje eshte me torkretim 10-15 cm, me zgare metalike, ne skarapten e pare prane rruges, ndersa ne skarpatat e tjera lart do kete sistemim I shpatit do te realizohet me rrjete celiku me përmasa kuadratike (60x80)mm, me \varnothing (2.2÷2.4) mm, rezistence =1770 N/mm², ndersa gozhdet qe do te përdoren për fiksimin e rrjetes do te jene gozhde me \varnothing 32 mm, me gjatesi L= 5 m dhe hap 3x3 m qe te sigurohet qepja deri ne shtresen me te forte sipas te dhenave gjeologjike dhe tub drenazhimi me gjatesi L=20m.

Tubi dreanzhimit do instalohet pasi te jete bere hapja/shpimi I vrimes me sonde dhe pastrimi I vrimes me ajer gjate procesit te shpimit, me koke shpimi me diameter 76 mm, ne menyre qe te futet tubi me diameter 50 mm me vrima dhe I mbeshjtelle me gjeotekstil.

Tek specifikimet teknike me poshtë do te gjeni bashkengjitur edhe parametrat fizik te tubave HDPE 100

Ne cdo berme do te ndertohen edhe kanale te cilat do ndihmojne ne largimin e ujerave nentokesore dhe sipërfaqesore, te cilat shkarkojne ne tombinot me te aferta.

Nje mbrojtje e orientuar nga përballimi i fenomeneve lokale dhe rrjedhje materiali ne kete zone.




Figure 3 Seksion tip/ prerje terthore Zona 1-Lot1 km 1+980.97

Torkretimi përdoret për mbrojtjen e sipërfaqeve të ekspozuara të shkëmbinjve që mund të përkeqesohen kur ekspozohen ndaj ajrit, faktoreve klimatik. Duke qene se në këto zone janë shkëmbinj flishore që janë dobësuar si pasojë e ndikimit nga proceset e ndryshme klimatike (ndryshimet e temperaturave, reshjet, niveli i ujerave nentokesore) për të mbrojtur shpatet ose prerjet që mund të gerryhen me kalimin e kohës ose të përkeqesohen.

Ne raport është paraqitur vetëm mbrojtja e një prej seksioneve të zgjidhjes. Seksionet dhe detajet të shihen në fletë të projektit.




Figure 4 Pamja në plan për mbrojtjen në Zonën 1-Lot 1 nga km 1+669.89÷1+980.97

a. Loti 1 –Zona 2 e mbrojtjes, segmenti 3+395.34÷3+843.58

Përshkrimi litologjik i shkembinjve qe takohen ne Zonën 2 km 3+395 deri km 3+520, Lot1:

Ne kete segment takohen shkembinjte FLISHORE te përfaqesuar prej kombinimit te shkembinjve Argjilite, Alevrolite dhe Ranore kokrrize-imet. Jane me ngjyre gri dhe bezhe e me njolla ndryshku, te dobet, me çimentim mesatar, shume te përjruar dhe te oksiduar ne sipërfaqe, e me shume çarje te cilat jane te hapura e te lira. Trashesia e shtreszimeve varion nga 1-20cm (ranori) dhe 2-7cm argjiliti.

Ne pjesen e sipërme te skarpates shtresat e ranorit jane te liruara e te hapura, gje qe ka prirje për te rene materiali nga skarpata ne rreze te saj deri ne trupin e rruges, te ndihmuar sidomos gjate sezonit te reshjeve dhe si rezultat ka grumbullime te dherave ne bazen e skarpates.



Figure 5 Foto: km 3+800

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Tek kjo zone duke qene se kemi përseri shkembinjte flishore te përfaqesuar prej kombinimit te shkembinjve argjilite, alevrolite dhe ranore kokrrize-imet parashikohet mbrojtja me shotcrete 10-15 cm, me zgare metalike, me gozhde \varnothing 32 mm, me gjatesi $L=5$ m dhe hap 3×3 m, skarpaten e pare prane trupit te rruges, ndersa ne skarpatat me larte do behet sistemim vetem me rrjete celiku me përmasa kuadratike (60x80)mm, me \varnothing (2.2÷2.4) mm, rezistence =1770 N/mm², ndersa gozhdet qe do te përdoren për fiksimin e rrjetes do te jene gozhde me \varnothing 32 mm, me gjatesi $L=5$ m dhe hap 3×3 m, gjithashtu drenazhimi I skarpatave do realizohet me tub drenazhimi me gjatesi $L=20$ m.




Figure 6 Seksion tip/ prerje terthore Zona 2-Lot1 km 3+519.79




Figure 7 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 2 – Lot 1 nga km 3+395.34÷3+843.58

Ne kete segment duke qene se edhe ka prani te ujerave nentokesore vendosja e tubave te drenazhimit kryen nje funksion te rëndesishem ne drenazhimin e shpatit, ku me poshtë tek specifikimet teknike do te gjeni bashkengjitur edhe parametrat fizik te tubave HDPE 100.

Ne raport eshte paraqitur vetem mbrojta e nje prej seksioneve te zgjidhjes. Seksionet dhe detajet te shihen ne flete e projektit.

a. Loti 1 –Zona 2a e mbrojtjes, segmenti 4+394.95÷4+500

Ne kete sektor takohen shkembinjte FLISHORE te përfaqesuar prej kombinimit te Ranoreve kokrrize-imet me ndershtresa te holla Argjilitesh. Ranoret jane shtrese-trashe deri ne 2m, dhe me shume çarje te tjera te mbushura nga suargjilat me ngjyre grin e bezhe. Gjenden blloqe shkembore ranori te rena nga shpati dhe te depozituar ne rreze te tij,



Figure 8 Foto: km 4+395 deri ne km 4+500.

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Duke qene se ne pjesen e sipërme te skarpates shtresat e ranorit jane te liruara e te hapura, gje qe ka prirje për te rene materiali nga skarpata ne rreze te saj deri ne trupin e rruges, eshte parashikuar mbrojtje me torkretim 10-15 cm me zgare metalike, gozhde me diameter 32, L=5 m me hap 3x3 m e skarpates prane trupit te rruges, ndersa skarpatat lart do sistemohen vetem me rrjete celiku me përmasa kuadratike (60x80)mm, me \varnothing (2.2÷2.4) mm, rezistence =1770 N/mm², ndersa gozhdet qe do te përdoren për fiksimin e rrjetes do te jene gozhde me diameter 32, L=5 m me hap 3x3 m, drenazhimi do realizohet me tub drenazhimi L=20 m, sic paraqitet me poshtë ne seksionin tip.




Figure 9 Seksion tip/ prerje terthore Zona 2 a-Lot1 km 4+454.32




Figure 10 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 2 a – Lot 1 nga km 4+394.95÷4+500

Ne raport eshte paraqitur vetem mbrojta e nje prej seksioneve te zgjidhjes. Seksionet dhe detajet te shihen ne flete e projektit.

a. Loti 4 –Zona 2b e mbrojtjes, segmenti 7+198.08÷7+250+15m rakordim

Ne kete zone takohen shkembinjte FLISHORE te përfaqesuar prej kombinimit te shkembinjve argjilite, Alevrolite dhe Ranore kokrrize-imet. Jane me ngjyre grit e erret, mesatarisht te dobet, me çimentim mesatar, te përjruar ne sipërfaqe. Sipër jane te mbuluar me suargjilat çakullore te origjines flishore. Keta shkembinj jane te erroduar ne sipërfaqe prej faktoreve natyrore.

Ne skarpata ka shplarje te tyre gjate sezonit te reshjeve dhe si rezultat grumbullime te dherave ne bazen e skarpates.



Figure 11 Foto nga Km 7+198.08 ÷ 7+250 + 15m rakordim

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Ne kete segment sipas formacionit gjeologjik ku shkembinjte flishore jane te mbuluar sipër me suargjilat çakullore te origjines flishore dhe jane te errduar ne sipërfaqe prej faktoreve natyrore eshte parashikuar mbrojtje me rrjete celiku me përmasa kuadratike (60x80)mm, me \emptyset (2.2÷2.4) mm, rezistence =1770 N/mm², multimat(geocell) qe ben te mundur edhe rritjen e vegjetacionit, te cilat fiksohen me gozhde me diameter 32 , gjatesi 5 m dhe hap 3x3.




Figure 12 Seksion tip/ prerje terthore Zona 2 b-Lot 4 km 7+200




Figure 13 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 2 b – Lot 4 nga km 7+198.08 ÷ 7+250+15m rakordim

Kjo lloj mbrojtjeje ben te mundur qe zona te mos demtohet nga erozioni dhe eshte nje mbrojtje qe rezulton jo vetem ekonomike por edhe miqesore me mjedisin.

Ne raport eshte paraqitur vetem mbrojta e nje prej seksioneve te zgjidhjes. Seksionet dhe detajet te shihen ne flete e projektit.

a. Loti 4 –Zona 2a e mbrojtjes, segmenti 8+150÷8+225

Përshkrimi litologjik i shkembinjve qe takohen ne zone:

Ne kete zone takohen Depozitime te trasha te Terraces se vjeter Lumore te përbera nga Zhavorri kokerr-mesem, kokerr-trashe dhe me popla e blloqe shkembore te origjines karbonatike dhe flishore. Jane shume te ngjeshura dhe te drenuara, te thate. Përmbajne pak suargjila dhe surera me ngjyre bezhe.

Skarpata eshte e qendrueshme por ka shkeputje te zajeve dhe te poplave gjate reshjeve te renda te shiut.

Ka nevoje për mbrojtje nga shplarjet dhe erodimi i shkaktuar prej faktoreve atmosferike.



Figure 14 Foto ne terren nga Km 8+150-8+225

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Prania e zhavorreve kokerr-imet dhe kokerr-trashe, ne kete segment ka nevoje për mbrojtje pak me te thjeshte, e cila konsiston ne qepje te shpatit me rrjete celiku me përmasa kuadratike (60x80) mm, me \emptyset (2.2÷2.4) mm, rezistence =1770 N/mm², dhe gozhde me diameter 32, me gjatesi 5m dhe hap 3 x3 m, kjo lloj mbrojtjeje ben te mundur qe mos te shkeputen materiale, gure, popla, zaje nga faqja e shpatit dhe te bien ne trupin e rruges.

Ne raport eshte paraqitur vetem mbrojta e nje prej seksioneve te zgjidhjes. Seksionet dhe detajet te shihen ne flete e projektit.




Figure 15 Seksion tip/ prerje terthore Zona 2 a-Lot 4 km 8+200

Figure 16 Seksion tip/ (ne zona shume te dobeta me dhera) prerje terthore Zona 2 a-Lot 4 km 8+200




Figure 17 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 2 b – Lot 4 nga km 8+150÷8+225

a.Loti 4 –Zona 2 e mbrojtjes, segmenti 8+550÷9+425

Ne kete segment takohen shkembinjte GELQERORE strallore shtrese-holle shtrese-mesem. Trashesia e shtresezimeve eshte 5-15cm. Jane me ngjyre tebardhe (gelqeroret) dhe lejla (strallet), te forte, por me çarje. Disa çarje jane te mbushura me suargjila dhe surera me ngjyre kafe te erret. Apërtura e çarjeve eshte nga 5cm deri 20cm. Distanca e ketyre çarjeve varion nga 1m deri ne 2m (1.60m).



Figure 18 Foto: km 8+565 deri ne km 9+425 me shkembinjte gelqerore strallore dhe me çarje.

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Ndërhyrja përforcuese për këte zone është rrjete celiku me përmasa kuadratike (60x80) mm, me \emptyset (2.2÷2.4) mm, rezistence =1770 N/mm², me gozhde \emptyset 32mm, gjatesi L=5 m dhe hap 3x3 m. Keto ndërhyrje janë fleksibile, të cilat sigurojnë qepjen e shkëmbinjëve gelqerore të shtresëzuar duke ndihmuar në stabilizimin e shpatit.

Ne raport është paraqitur vetëm mbrojtja e një prej seksioneve të zgjidhjes. Seksionet dhe detajet të shihen në fletë e projektit.




Figure 19 Seksion tip/ prerje terthore Zona 2 -Lot 4 km 9+225

Ky segment përfshin disa zona me sipërfaqe relativisht të mëdha që duhen përfunduar për të mbrojtur rrugën nga rreshqitjet dhe renia e mundshme e gureve dhe copave shkembore.




Figure 20 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 2 – Lot 4 nga km 8+565÷9+425

a. Loti 4 –Zona 1 e mbrojtjes, segmenti 9+875÷12+800 dhe 12+925÷13+275

Ne kete sektor nga km 9+875÷12+800, jane takuar shkembinjte GELQERORE shtreseholle dhe shtrese-mesem, e te rrudhosur ne formen e strukturave sinklinale dhe antiklinale. Jane me ngjyre te bardhe dhe me shume çarje. Trashesia e shtresave gelqerore varion nga 5cm deri 30cm. Përbajne breza te holle strallore me forma te çrregullta, dhe ne distance nga 15 deri 75cm.



Figure 21 Foto: km 9+875 deri ne km 12+800 me shkembinjte gelqerore.




Figure 22 Foto: km 11+375 deri ne km 12+150 me shkembinjte gelqerore me çarje, shkarje dhe zgavrakarstike.

Ndersa ne segmentin 12+925÷13+275, jane takuar shkembinjte GELQERORE shtresore me ngjyre te bardhe, me shume sete çarjesh ne drejtime te ndryshme. Apërtura e çarjeve eshte nga 1-2cm deri 5-6cm. Trashesia e shtresezimeve varion nga 5cm deri 60cm. Gjithashtu ne faqen e skarpates gjenden edhe zona shume te prishura ne sipërfaqe, me ndonje zgaver (ne çarjet vertikale), te mbushur nga suargjilat kafe te erret dhe me copa çakullore. Gjeresia e zgavres eshte 1,3m. Çarjet e shumta dhe me drejtime te ndryshme i bejne shtresat shkembore qe te copetohen ne copa me te vogla gje qe krijon premisa për renien e ketyre masave shkembore nga lartesite mbi trupin e rruges.



Figure 23 Foto: km 12+925 deri ne km 13+275 me shkembinjte gelqerore shume te copetuar.

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Ne zonën e pare ne kete segment kemi nje mbrojtje skarpate me rrjete celiku me përmasa kuadratike (60x80)mm, me \varnothing (2.2÷2.4) mm, rezistence =1770 N/mm², gozhde me diameter 32, me gjatesi 4 m dhe hap 3 me 2.5 m nga njera tjetra, duke qene se shpati eshte me 2 berma dhe 3 skarpata te cilat nuk jane shume te larta ne krahasim me zonat qe vazhdojne me tej. Kjo qepje e shpatit paraqitet edhe me poshtë ne prerjen terthore ne kilometrin 9+925.

Ne raport eshte paraqitur vetem mbrojta e nje prej seksioneve te zgjidhjes. Seksionet dhe detajet te shihen ne flete e projektit.




Figure 24 Seksion tip/ prerje terthore Zona 1 -Lot 4 km 9+925

Ndersa ne kilometrin 11+125 eshte nje zone me skarpata goxha te larta, me 4 berma dhe me 5 skarpata te cilat do mbrohen me rrjete heksagonale dopio torsione, me gozhde me gjatesi 4m dhe hap 3x2.5 m, ndersa ne skarpaten e fundit fare do vendosen edhe rockfall barrier. Rrjete metalike qe do te sherbeje si barriere pritesese, kjo rrjete ka elasticitet te larte, dhe eshte e perbere nga fiye celiku me diameter 4mm qe formojne kuadrate me brinje 8cm dhe ka rezistence 1770N/mm², ku specifikimet perkatese jane paraqitur tek te dhenat teknike me poshtë. Lidhja e profileve mbajtes te kesaj rrjete behet ne themel betoni ose ne shkemb te forte dhe realizohet me dy ose tre bulona lidhes dhe pllake metalike dhe shtrengohet ne koke me kavu me diameter 12mm (sipas skemes se dhene ne vizatim) Profilet metalik mbajtes do te jene HEA 120 ne nje distance 6÷12m larg nga njeri tjetrit.

Ne raport eshte paraqitur vetem mbrojta e nje prej seksioneve te zgjidhjes. Seksionet dhe detajet te shihen ne flete e projektit.

Ne krye te skarpatave ka rrjedhje te formacionit shkembor te cilat duke rene nga lartesi shume te medha, marrin energji te larte dhe behen shume problematike për trupin e rruges dhe levizjen e mjeteve, barrierat bejne te mundur kapjen e ketyre materialeve te cilat variojne sipas energjise absorbuese nga 500 kJ deri ne 3000 kJ.




Figure 25 Seksion tip/ prerje terthore Zona 1 -Lot 4 km 11+125




Figure 26 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 1 – Lot 4 nga km 9+875÷12+800

Me poshtë jepet vazhdimi i mbrojtjes se skarpatave ne plan te segmentit 9+875-12+800 dhe 12+925 -13+275.




Figure 27 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 1 – Lot 4 nga km 12+925÷13+275

a. Loti 6 –Zona 3 e mbrojtjes, segmenti 16+675÷18+125

Ne kete zone nga km16+675deri km 18+125jane takuar shkembinjte Gelqerore dhe Gelqerore mergelore dhe me ndonje ndershtrese argjillore. Jane me ngjyre te bardhe, bezhe te çelet, gri ne te kaltert, shtrese holle, shume sisteme çarjesh, ne drejtime te ndryshme. Distanca e çarjeve varion nga 20cm deri 2-3m. Çarjet e shtresazimit jane te mbushura me suargjila kafe, me apërture 5-6cm. Trashesia e shtresave gelqerore varion nga 20cm deri 40cm. Kjo zone karakterizohet nga prania e shume zgavrave karstike te cilat ndodhen kryesisht ne planet e çarjeve te shtresazimit dhe jane te hapura 25-30cm.



Figure 28 Foto nga 16+675 dhe 18+125me shkembinjte gelqerore mergelore, alevrolite, dhe mergele me çarje dhe zgavra karstike.

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Sistemimi i shpatit do te realizohet me rrjete celiku me përmasa kuadratike (60x80) mm, me \varnothing (2.2÷2.4) mm, rezistence =1770 N/mm², ndersa gozhdet qe do te përdoren për fiksimin e rrjetes do te jene gozhde me \varnothing 28mm, gjatesi L=3 m.

Rrjete metalike qe do te sherbeje si barriere prites, kjo rrjete ka elasticitet te larte, dhe eshte e përbere nga fije celiku me diameter 4mm qe formojne kuadrate me brinje 8cm dhe ka rezistence 1770N/mm², ku specifikimet përkatëse jane paraqitur tek te dhenat teknike me poshtë. Lidhja e profileve mbajtes te kesaj rrjete behet ne themel betoni ose ne shkemb te forte dhe realizohet me dy ose tre bulona lidhes dhe pllake metalike dhe shtrengohet ne koke me kavo me diameter 12mm (sipas skemes se dhene ne vizatim) Profilet metalik mbajtes do te jene HEA 120 ne nje distance 6÷12m larg nga njeri tjetrit.

Duke qene se formacioni eshte me shkembinj gelqerore me mergela nuk eshte e nevojshme qe te behet qepje e shpati me gozhde me diameter 28mm ne forme shahu por vendosja e tyre do realizohet ne thyerje te seciles skarpate dhe me gjatesi L=3 m qe sherbejne vetem si fiksuese për rrjeten e varur.




Figure 30 Seksion tip/ prerje terthore Zona 3 -Lot 6 km 16+675

Ne zonën me kilometer 17+000 përveç qepjes së skarpates me ankora dhe rrjete, do vendoset barriere pritese. Kjo rrjete ka elasticitet të lartë, dhe është e përbërë nga fije celiku me diametër 4mm që formojnë kuadrate me brinjë 8cm dhe ka rezistencë 1770N/mm². Lidhja e profileve mbajtes të kësaj rrjete bëhet në shkëmb të dobët, në themel betoni ose në shkëmb të fortë dhe realizohet me dy ose tre bulona lidhës dhe pllake metalike dhe shtrengohet në koke me kavo me diametër 12mm (sipas skemës së dhënë në vizatim). Profilet metalik mbajtes do të jenë HEA 120 në një distancë 6÷12m larg nga njëri tjetrit. Pastaj në kilometrin 17+600 formacioni është përseri me shkëmbinj gelqeror shtresorë pllakorë, të bardhë, me shumë çarje dhe qepja e shpatit bëhet me rrjete dhe gozhde me diametër 28, me gjatësi 3 m në thyerje të skarpatave, gozhde në këte rast shërbejnë për kapjen ose fiksimin e rrjetës së varur.




Figure 29 Seksion tip/ prerje terthore Zona 3 -Lot 6 km 17+600

Sistemimi i shpatit do të realizohet me rrjete heksagonale, dopio torsion, me përmasa kuadratike (60x80)mm, me \varnothing (2.2÷2.4) mm, rezistencë =1770 N/mm², ndërsa ankorat që do të përdoren për fiksimin e rrjetës do të jenë gozhde me \varnothing 28mm, gjatësi L=3 m, ku me poshtë tek specifikimet teknike do të gjëni bashkëngjitur edhe parametrat fizik të materialeve të përdorura .

PRERJE TERTHORE
Zona 3/ Lot-6
Shkalla 1:250




Figure 30 Seksion tip/ prerje terthore Zona 3 -Lot 6 km 17+750

Ne kilometrin 17+750 eshte zone qe ka patur shkarje dhe ka formacion shume te dobet, mbrojtja e parashikuar për kete rast eshte me shotcrete/torkretim 10-15 cm me zgare metalike ne mes te shtresave te shotcrete, gozhde me diameter 28mm, me gjatesi 3 m dhe prania e ujerave nentokesore qe do largohen me ane te tubave te drenazhimit me gjatesi 20 m.

Zona 3/ Lot-6




Figure 31 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 3 – Lot 6 nga km 16+675÷18+125

a. Loti 6 –Zona 2 e mbrojtjes, segmenti 18+500÷19+225

Përshkrimi litologjik i shkembinjve që takohen në zone:

Në këtë zonë nga km 18+500 deri në km 19+225 rruga është e ndërtuar në një yrsek midis shkembinjve gelqerorë. Në këtë segment takohen shkembinjte GELQERORE shtresore pllakore, me ngjyrë të bardhë, me shumë çarje në drejtime të ndryshme, ku janë matur disa cipa kalcitike dhe okside hekurorë. Hapja e çarjeve të shtresëzimit është e mbushur me suargjila kafe. Trashësia e shtresave gelqerore varion nga 7cm në 12cm, 20cm, 31cm. Përmbajnë edhe breza të holle strallesh me trashësi deri 10cm. Në të gjithë këtë zonë gjenden disa zgavra të medhaja, të krijuara në disa çarje tektonike (faults) dhe prej proceseve të karstëzimit të shkembinjve gelqerorë, qeshtë karakteristike shumë e përhapur në këtë lloj shkëmbi. Madhësia e zgavrave ndryshon nga 1-2m deri në 10m. Gjate ndërtimit të rrugës ka ndodhur një shkarje e madhe e shkembinjve gelqerorë pllakore nga shpati përendimor i rrugës. Këtu faqet e planeve të çarjeve të shtresëzimit janë të sheshta dhe të lemuara. Plani i shkarjes, është paralel me planet e shtresëzimit dhe me rënje për nga trupi i rrugës. Çarjet e shtresëzimit janë të hapura, dhe të mbushura me suargjila kafe dhe ka shenja të filtrimeve të ujit nëntokësor.




Figure 32 Foto nga km 18+500 deri në km 19+225

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Sic eshte paraqitur qe ne fillim qe sipas tipologjive te formacioneve kemi parashikuar edhe disa tipologji mbrojtjeje qe ne segmente me gjeologji te ngjshme kemi te njejten zgjidhje për stabilizimin e skarpates.

Rrjeta e varur do jete hegzagonale, dopio torsione, ndersa gozhdet ne kete rast do jene $\varnothing 28$, gjatesi $L=3$ m dhe vendosja e tyre do realizohet ne thyerje te seciles skarpate.

Sistemimi i shpatit do te realizohet me rrjete celiku me përmasa kuadratike (60x80)mm, me \varnothing (2.2÷ 2.4) mm, rezistence =1770 N/mm², ndersa gozhdet qe do te përdoren për fiksimin e rrjetes do te jene gozhde me \varnothing 28mm, gjatesi $L=3$ m.




Figure 33 Seksion tip/ prerje terthore Zona 2 -Lot 6 km 19+150

Zona 2/ Lot-6




Figure 34 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 2 – Lot 6 nga km 18+500÷19+225

a. Loti 6 – Zona 1 e mbrojtjes, segmenti 19+650÷20+275

Përshkrimi litologjik i shkembinjve që takohen në zone:

Në këtë zonë rruga është e ndërtuar në një yrsek midis shkembinjve gelqerorë, dhe me një këthë rrethore që e ndryshon drejtimin nga Veri-Lindje në Jug-Përendim. Shkembinjte GELQERORE janë të forta, me ngjyrë të bardhë, shtresë hollë deri shtresë mesem, pak të rrudhosur, me zhytje për nga Jug-Përendimi, me shumë çarje në drejtime të ndryshme, duke i dhënë pamjen copezore. Apërtura e çarjeve të shtresëzimit varion nga 0.5cm deri 5-6cm.

Gjenden çarje tërthore me faqe të onduara, të ashpra, të veshura nga oksidet hekurorë.



Figure 40 Foto: km 19+650 deri në km 20+275 me shkembinjte gelqerore me çarje, shkarje dhe zgavra karstike.

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Edhe ne segmentin me kilometer 19+650 deri ne 20+275 kemi përseri nje zone me shkembinj gelqerore te forte, shtrese holle dhe pak te rrudhosur, keshtu qe mbrojtja vazhdon te jete njesoj si ne yrsekun e meparshem dhe ne baze te nivelit te cashmerise se shkembinjve eshte parashikuar qepja e shpatit me rrjete ku me poshtë tek specifikimet teknike do te gjeni bashkengjitur edhe parametrat fizik sa j dhe gozhde me diameter 28 mm dhe me gjatesi 3m ne thyerjet e skarpatave.




Figure 35 Seksion tip/ prerje terthore Zona 1 -Lot 6 km 19+875




Figure 36 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 1 – Lot 6 nga km 19+650÷20+275

a. Loti 5 – Zona 7 e mbrojtjes, segmenti 20+350÷20+425

Ne kete zone nga km 20+350 deri ne km 20+425, me koordinata sipas sistemit 34T UTM: E:414583/ N: 4430413, jane takuar shkembinjte GELQEROREshtresore me ngjyre te bardhe, te forte, por me shume çarje dhe krisje te shumta. Trashesia eshtresave gelqerore varion nga 5cm deri 25cm. Gjithashtu gjenden disa zgavra. Ne bazen eskarpatës, pas murit prites, gjenden blloqe shkembore te rena nga faqja e skarpates, te cilat mund te bien edhe ne trupin e rruges.



Figure 37 Foto: km 20+350 deri ne km 20+425 me shkembinjte gelqerore me shume çarje.

Duke qene se ne bazen e skarpates gjenden blloqe shkembore te rena nga faqja e skarpates, ndërhyrja për te mbrojtur trupin e rruges dhe mjetet që do qarkullojne aty eshte me se e nevojshme. Me poshtë paraqitet edhe ndërhyrja e përshtatur sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Skarpatat ne kete segment jane te uleta dhe mbrojtja e tyre eshte parashikuar vetem me rockfall barrier, barriera mbrojtese te cilat pengojne ose bllokojne materialet qe vijne nga lart, me nje energji qe fitojne gjate renies. Struktura eshte e përbere nga rrjete metalike qe do te sherbeje si barriere pritese. Kjo rrjete ka elasticitet te larte, dhe eshte e përbere nga fije celiku me diameter 4mm qe formojne kuadrate me brinje 8cm dhe ka rezistence 1770N/mm². Lidhja e profileve mbajtes te kesaj rrjete behet ne shkemb te dobet, ne themel betoni ose ne shkemb te forte dhe realizohet me dy ose tre bulona lidhes dhe pllake metalike dhe shtrengohet ne koke me kavo me diameter 12mm. Profilet metalik mbajtes do te jene HEA 120 ne nje distance 6÷12m larg nga njeri tjetrit.

Plani i mbrojtjes se skarpates

Zona 7/ Lot-5

Shkalla 1:750




Figure 38 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 7 – Lot 5 nga km 20+350+20+425

a. Loti 5 –Zona 6b e mbrojtjes, segmenti 20+660÷20+800

Ne kete zone nga km 20+660 deri ne km 20+800, ne pjesen e pare ne fillim te saj gjenden shkembinjte GELQERORE me shume çarje e te copetuar, e me disa zona prishjeje ku nuk dallohen qarte shtresezimet. Ne faqen e skarpates gjenden blloqe shkembore qe rrezikojne te rrezohen poshtë ne rruge. Ne pjesen tjetër për nga fundi i kesaj zone shfaqen shkembinjte GELQERORE shtresore, me ngjyre te bardhe, te fortee, por me çarje dhe me shume krisje (cracks). Trashesia e shtresezimeve varion nga 5cm deri ne 40cm. Ne bazen e skarpates, pas murit prites, gjenden blloqe shkembore te rena nga faqja e skarpates, te cilat mund te bien edhe ne trupin e rruges.



Figure 39 Foto: km 20+660 deri ne km 20+800 me shkembinjte gelqerore pllakore dhe shume te çare.

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Sistemimi i shpatit do te realizohet me rrjete celiku me përmasa kuadratike (60x80) mm, me \varnothing (2.2÷2.4) mm, rezistence =1770 N/mm², ndersa gozhdet qe do te përdoren për fiksimin e rrjetes do te jene gozhdje me \varnothing 28mm, gjatesi L=3 m.

Rrjete metalike qe do te sherbeje si barriere pritesese, kjo rrjete ka elasticitet te larte, dhe eshte e përbere nga fije celiku me diameter 4mm qe formojne kuadrate me brinje 8cm dhe ka rezistence 1770N/mm². Lidhja e profileve mbajtes te kesaj rrjete behet ne temel betoni ose ne shkemb te forte dhe realizohet me dy ose tre bulona lidhes dhe pllake metalike dhe shtrengohet ne koke me kavo me diameter 12mm (sipas skemes se dhene ne vizatim) Profilet metalik mbajtes do te jene HEA 120 ne nje distance 6÷12m larg nga njeri tjetrit.

Duke qene se formacioni eshte me shkembinj gelqerore nuk eshte e nevojshme qe te behet qepje e shpati me gozhdje ne forme shahu por vendosja e tyre do realizohet ne thyerje te seciles skarpate dhe me gjatesi L=3 m qe sherbejne vetem si fiksuese për rrjeten e varur.




Figure 40 Seksion tip/ prerje terthore Zona 6 b -Lot 5 km 20+725




Figure 41 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 6 b – Lot 5 nga km 20+660÷20+800

a. Loti 5 – Zona 6a e mbrojtjes, segmenti 20+894÷21+245

Ne kete zone nga km 20+894 deri ne km 21+245, gjenden shkembinjte GELQERORE shtresore pllake holle, me ngjyre te bardhe, te forte, por me çarje dhe me shume krisje (cracks). Trashesia e shtresezimeve varion nga 5cm deri ne 20cm. Ne bazen e skarpates, pas murit prites, gjenden blloqe shkembore te rena nga faqja e skarpates, te cilat mund te bien edhe ne trupin e rruges.



Figure 42 Foto: km 20+894 deri ne km 21+245 me shkembinjte gelqerore pllakore dhe me blloqe te rrezuar.

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Segmenti me kilometer 20+894 deri ne 21+245 sipas formacionit, përshkrimit gjeologjik qe jepej me lart do mbrohet me ane te rrjetes dopio torsione, e cila do fiskohet me gozhde me diameter 28 mm dhe gjatesi 3m, ne thyerje te skapatave dhe me rockfall barrier.




Figure 43 Seksion tip/ prerje terthore Zona 6 a -Lot 5 km 21+025

Rockfall barrier qe do te sherbeje si barriere pritese, kjo rrjete ka elasticitet te larte, dhe eshte e perbere nga fije celiku me diameter 4mm qe formojne kuadrate me brinje 8cm dhe ka rezistence 1770N/mm². Lidhja e profileve mbajtes te kesaj rrjete behet ne temel betoni ose ne shkemb te forte dhe realizohet me dy ose tre bulona lidhes dhe pllake metalike dhe shtrengohet ne koke me kavo me diameter 12mm (sipas skemes se dhene ne te vizatuar ne seksionin tip) Profilet metalik mbajtes do te jene HEA 120 ne nje distance 6÷12m larg nga njeri tjetrit.




Figure 44 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 6 a – Lot 5 nga km 20+894÷21+245

Skarpatat ne kete segment jane te larta, përbehen nga 6 berma dhe 7 skarpatata qe do realizohet ndërhyrja për mbrojtjen e trupit te rruges.

a. Loti 5 –Zona 6 e mbrojtjes, segmenti 21+260÷21+390

Ne kete zone nga km 21+260 deri ne km 21+390, takohen shkembinjte GELQERORE shtresore, te rrudhosur dhe me renie gati vertikale. Shtresat nderpriten nga shume çarje te tjera me drejtime dhe renie te ndryshme. Prane fundit te kesaj zone gjendet nje çarje e madhe me gjeresi 12-15m ne bazen e skarpates dhe vjen duke u ngushtuar ne nivelet e sipërme te shpatit. Kjo çarje eshte e mbushur me suargjila me ngjyre kafe dhe gri ne bezhe e me njolla ndryshku. Jane me pak lageshti, te ngjeshura. Ne ane te kesaj çarje shkambi gelqeror eshte shume i copetuar.



Figure 45 Foto: km 21+260 deri ne km 21+390 me shkembinjte gelqerore shtresore, te rrudhosur dhe me shume çarje.

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

Ne segmentin me kilometer 21+260-21+390 sic verejme edhe ne përshkrimin gjeologjik, ndryshimi qe kemi ne mbrojtjen e skarpates vjen si pasoje e carjeve te medha ne kete zone dhe keto carje jane te mbushura me surgjila. Si rrjedhoje e këtij formacioni nuk mund te aplikojme nje mbrojtje te thjeshte sic kemi pare me lart ne formacione ku kemi shkembinj gelqeror te frakturuar.

Ne sekionin tip me poshtë ne kilometrin 21+300 paraqitet mbrojtja me rrjete dhe me gozhde me diameter 28 mm, me gjatesi 3 m, me hap vendosjeje 3x3 m. Pra ne kete rast ankorat nuk do kryejne vetem funksion te fiksimit te rrjetes. Hapi i vendosjes se ankorave eshte i tille sepse sherben edhe për fiksimin, qepjen e copave shkembore qe jane te copetuara.




Figure 53 Seksion tip/ prerje terthore Zona 6 -Lot 5 km 21+300

Plani i mbrojtjes se skarpates
Zona 6/ Lot-5
Shkalla 1:750




Figure 46 Pamja ne plan për mbrojtjen ne Zonën 6 – Lot 5 nga km 21+260÷21+390

Sistemimi i shpatit do te realizohet me rrjete celiku me përmasa kuadratike (60x80)mm, me \emptyset (2.2÷2.4) mm, rezistence =1770 N/mm², ndersa gozhdet qe do te përdoren për fiksimin e rrjetes do te jene gozhde me \emptyset 28mm, gjatesi L= 3m , me hap 3 m, ne forme shahu.

a. Loti 5 – Zona 5 e mbrojtjes, segmenti 21+430÷21+575

Përshkrimi litologjik i shkëmbinjve që takohen në zonë:

Në fillim të kësaj zone në km 21+400 është kontakti i gelqeroreve me flishin. Në këtë zonë nga km 21+430 deri në km 21+575, takohen shkëmbinjtë Flishore të përfaqësuar nga kombinimi i shtresave me Argjilite, Alevrolite dhe Ranore. Janë të dobët, me ngjyrë gri, me çimentim të mirë, shtrese holle. Pranë sipërfaqes janë të përjarruar dhe me ngjyrë bezhe në gri. Shtresëzimet janë me rënie gati vertikale me trashësi 3-20cm.



Figure 47 Foto: km 21+430 deri në km 21+575 me shkëmbinjtë Flishore (Argjilite, Alevrolite, Ranore).

b. Zgjidhja sipas formacionit gjeologjik te këtij segmenti.

